

SILLABUSI i Lëndës PSIKOLOGJI E PERSONALITETIT

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Psikologji e personalitetit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I^{rë}
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	L-P4 e mërkurë 16-18:15, U-salla e informatikës e martë 12-12:45-13:30
Mësimdhënësi i lëndës: Asistenti /ja:	Dr. sc. Rrezarta Avdyli Ass.Mr. Blerta Perolli Shehu
Detajet kontaktuese: Rrezarta Avdyli (F.i Edukimi: kati i IV-zyra nr. 16) Blerta Perolli -Shehu	rrezarta.avdyli@uni-pr.edu blerta.shehu@gmail.com ;
Përshkrimi i lëndës	<p><i>Në këtë lëndë mbi Psikologjinë e Personalitetit do të njoftohen studentët me konceptet bazë që e përkufizojnë këtë shkencë ,me fushën e studimit, teoritë themelore, si dhe me metodologjinë e saj.</i></p> <p><i>Lënda përfshinë bazat e psikologjisë së personalitetit, njohuritë mbi pikëpamjet teorike të ndryshme rreth konceptimit të personalitetit të njeriut, ngjashmërive dhe dallime mes individëve.</i></p> <p><i>Përmes kesaj lënde pretendohen të qartësohen proceset e ndryshme mendore dhe sjellja e njeriut të shpjeguara nga formimi i karakterit si unik dhe njëherazi i ndikuar nga të tjeret dhe mjedisi.</i></p> <p><i>Ndërlidhja e informatave të ndryshme që trajtohen do te jetë tema kryesore e njohurive të përfitura e të arritura nga studentet, sepse një subjekt i kësaj lënde i studimit kaq kompleks në një periudhë kohore kaq të shkurter mund të jetë më shumë se informim i përgjithshëm mbi konceptet e psikologjisë së personalitetit.</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Arritja e njohurive të përgjithshme në fund të semestrit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Përftimi i njohurive mbi zhvillimin e personalitetit, duke përfshirë këtu teoritë e Frojdit, Jungut, Maslout, Roxhersit e të tjerëve;

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Të kuptuarit e personalitetit të njeriut, si formohet, si zhvillohet dhe si ndikon në sjelljet e njeriut ○ <i>Mbi konceptine psikologjisë si shkence në vete, por e ndërlidhur me shume diciplina tjera.</i> ○ <i>Të zhvillohet reflektimi personal dhe mendimi kritik mbi komplikueshmerinë e proceseve psikike dhe jetës psikike në përgjithësi.</i>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Reflekojnë për rëndësinë e njohjes së personalitetit të njeriut dhe formave si zhvillohet ai personalitet; ○ Reflekojnë mbi teoritë dominante mbi zhvillimin e personalitetit; ○ Njohin funksionet e brendshme të veçanta të individit dhe dallimet mes dy individëve; ○ Kuptojnë si zhvillohen dhe si ndikojnë në njëri-tjetrin; ○ Reflekojmë mbi zhvillimin e personalitetit, karakterin dhe temperamentin personal të tyre.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15 javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15 javë	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5 ditë	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	1	10 ditë	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10 ditë	30
Përgaditja përfundimtare për provim	30		30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	3 ditë	9
Projektet,prezentimet ,etj	2	4 ditë	8
Totali			137

<p>Metodologjia e mësimëdhënies:</p>	<p><i>Korniza teorike mbi konceptet e psikologjisë së personalitetit, proceseve të zhvillimit të tij si dhe shpjegimet teorike të mundshme, do të arrihet përmes ligjërimit formal. Këto njohuri do të zgjerohen e qartësohen pastaj edhe në orët e praktikave/ ushtrimeve, duke pasur mundësinë që të zgjerojnë konceptet bazë duke i vënë ato në praktikë sipas koncepteve dhe konteksteve të ndryshme që lënda lejon të sillen në orë.</i></p> <p><i>Studentët ftohen të jenë aktiv me qëllim që të përgaditen për procesin e mësimin dhe të zhvillimit të aftësive përkatëse përmes:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Vlerësimin në mënyrë kritike të njohurive që kanë dhënëpërmjet debateve si në ushtrime, ashtu edhe në ligjerata.</i> • <i>Pjesëmarrjes aktive në punimet e tyre dhe të tjerëve si dhe diskutimit rreth qështjeve të trajtuara në lëndë.</i>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p><i>Për paraqitjen në provim është e domosdoshme të keni vijuar në ushtrime 80% prej tyre. Prandaj, studentet të cilet i nënshtrohen vetëm testit, nuk mund të arrijnë më shumë se 8 në provim.</i></p> <p><i>Provimi objektiv- tipit test 80%</i> <i>Provimi është test me 3 alternativa apo zgeidhje. Për të kontrolluar rastësimin e përgjigjeve Testi do të ketë minus pikë, çka domëthënë se, nga përgjigjet e dhëna për çdo dy pikë të gabuara hiqet një e qelluar.</i></p> <p><i>Vijueshmëria në praktika / Ushtime 10%</i> <i>Prezantimi i punimit individual apo grupor 10%</i></p> <p><i>Nota përfundimtare është shuma e këtyre përqindjeve.</i></p>
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura bazë:</p>	<p><i>Psikologji e Personalitetit- Arben Hoti, Tiranë, 2012</i> <i>Teoritë e Personalitetit"- George Boeree, Tiranë, 2004.</i> <i>"Psikologjia shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerzore"- Morris, CH.G. & Maisto, A.A.</i> <i>"Psikologjia -Një hyrje koncize- Pettijohn. F. Terry, 1996.</i></p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p><i>Kaptina nga Psikologjia, Neki Juniku, Shkup, 1994</i> <i>Psikologjia, Ylli Zhurda, Tiranë, 2009.</i> <i>Psikologji e përgjithshme, Pajazit Nushi, Prishtinë, 2002</i> <i>Psikologjia e Fëmijës-Shkenca moderne, Vasta, R., Haith,</i></p>

	<p>M.M., dhe Miller, S.A. <i>Life Span Development, John W. Santrock, University of Texas Dallas, 2004.</i> <i>Introduction to Psychology; Stangor, Ch (2011). E-book</i> <i>Psicologia de la Personalidad; Bermudez, Perez, Ruiz, Sanjuan & Rueda, Madrid 2011</i></p>
--	--

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<i>Prezentmi i lëndës</i>
<i>Java e dytë:</i>	<i>Tema 1. Hyrje në Psikologji të Personalitetit</i>
<i>Java e tretë:</i>	<i>Tema 2. Personaliteti, struktura e tij dhe bazat biologjike</i>
<i>Java e katërt:</i>	<i>Tema 3. Faktoret Social dhe kulturor në formimin e Personalitetit</i>
<i>Java e pestë:</i>	<i>Tema 4. Temperamenti</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<i>Tema 5. Teoritë Psikoanalitike të Personalitetit Freud</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<i>Tema 6. Teoria analitike e Jungut</i>
<i>Java e tetë:</i>	<i>Tema 7. Psikologjia Individuale e Adlerit, Horney dhe Eriksoni</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<i>Tema 8. Teoritë e tipareve: Allport, Cattell, Eysenck, Big Five</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>Tema 9. Teoritë humaniste: Maslow, Rogers</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>Tema 10. Teoritë bihejvioriste dhe të mësuarit social</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>Tema 11. Teoritë konstitucionale: Kretschmer dhe Sheldon</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<i>Tema 12. Çrregullimet e personalitetit</i>
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	<i>Tema 13. Vlerësimi dhe testet e personalitetit</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<i>Riperseritje e lëndës apo rikapitullim</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët janë të obliguar të jenë të pranishëm në të gjitha ligjeratat dhe ushtrimet. Studentët janë të obliguar të respektojnë kohën e fillimit të ligjeratave dhe shkyqjen e telefonave mobil. • Secila mungesë e paarsyeshme do të mirret parasysh, dhe nëse studenti ka më shumë se tri mungesa do të ndikojnë në vlerësim dhe nuk do të ketë të drejtë të merr pjesë në provim. • Studentët inkurajohen të participojnë në ushtrime duke shtruar pyetje, përgjigjur në pyetje, duke dhënë ide, mendime, komente dhe duke kontribuar në mësimin e lëndës. Një pjesëmarrje e tillë pozitive dhe aktive do të rezultojë pozitivisht në notën përfundimtare. • Studentët do të vleresohen me provime gjysëm-semesterale, punime, prezente, seminare si dhe detyra tjera që do të jipen gjatë semestrit. Kryerja e këtyre punimeve do të shpërblehet në notën përfundimtare • Studentët janë të obliguar të marrin pjesë në ushtrime dhe të lexojnë kapitujt paraprakisht. Ushtrimet do të organizohen në formë të diskutimeve, punëve në grupe, si

dhe seminareve. Pritet një pjesëmarrje aktive si në diskutime dhe punë grupore. Në ushtrime do të diskutohen temat e ligjërara, si dhe do të plotësohen në ushtrime përmes artikujve të ndryshëm shkencor dhe literaturës plotësuese.

- *Studentët janë të obliguar të respektojnë kolegët gjatë punës grupore dhe diskutimeve dhe të respektojnë këndvështrimet dhe mendimet e secilit student në vete.*